

# Kredi për Makinë

## Informacion rreth Bankës

### Intesa Sanpaolo Bank Albania

Drejtoria Qendrore: Rr "Ismail Qemali", Nr. 27,  
Kutia postare 8319  
1001 Tirane, Shqipëri  
Tel: +355 4 22 76 000; Fax +355 4 22 48 762  
Website: www.intesasanpaolobank.al

## Karakteristikat dhe rreziqet e "Kredi për makinë"

### Karakteristikat e "Kredi për makinë"

Kredia për makinë ofrohet nga Intesa Sanpaolo Bank Albania që të përdoret nga kredimarrësit për blerjen e makinave të reja dhe të përdorura. Ofrohet në monedhën vendase Lek dhe në monedhë të huaj Euro. Banka financon blerjen e makinave të reja dhe të përdorura nga konkensionarët ose agjentët e tregtimit të makinave.

- Klienti duhet të ketë një punë me kohë të plotë dhe minimumi një vit pune për punëdhënësin aktual
- Vlera DSCR (raporti për mbulimin e borxhit) duhet të jetë minimalisht 1.4
- Klienti duhet të deklarojë të ardhurat: pagën dhe çdo burim tjetër të të ardhurave
- Bashkë-kredimarrës/Garantor: Aplikohet vetëm nëse është e nevojshme
- Sigurimi i plotë Casco është i detyrueshëm: Paguhet çdo vit
- Sigurimi i jetës: Rinovohet çdo vit për shumën e papaguar të kredisë
- Limiti i moshës së klientit: Minimumi 20 vjeç / Maksimumi 65 vjeç në datën e maturimit të kredisë
- Parapagimi: Lejohet
- Disbursimi: Kredia do të disbursohet 100% në llogarinë rrjedhëse të agjentit/koncensionarit të cilat do të kalojnë përmes llogarisë së kredisë së klientit
- Noterizimi i kontratave: Është i detyrueshëm / Paguhet nga klienti
- Regjistrimi i kolateralit në Zyrën e Regjistrimit të Pengut: Është i detyrueshëm / Paguhet nga klienti

Kolaterali për makinë të re:

- a) Barrë siguroese mbi makinë – Certifikata e regjistrimit të barrës siguroese
  - b) Sigurimi i plotë Kasko
  - c) Sigurimi i jetës së huamarrësit duhet për një kredi në vlerën mbi EURO 40,000
- Kolaterali për makinë të përdorur:
- a) Barrë siguroese mbi makinë – Certifikata e regjistrimit të barrës siguroese
  - b) Sigurimi i plotë Kasko

### Tregu i synuar

Klientela e synuar për këtë produkt janë të gjithë individët me të ardhura mujore të qëndrueshme. Ky produkt ofrohet vetëm për rezidentët shqiptar.

### Opsione të tjera shtesë

Pjesëmarrja e Bankës, afati dhe shuma që akordohet do të jetë e ndryshme për makina të reja dhe të përdorura:

- Pjesëmarrja: 75% e vlerës për makina të reja dhe 65% për makina të përdorura
- Periudha e Përdorimit:

Do të financohen vetëm makinat të cilat janë në përdorim, për maksimumin 8 vjet deri në fund të maturimit të kredisë.

### Dokumentet e nevojshme

Dokumentet për individët e punësuar

- Kartë identiteti / Pasaportë
- Certifikatë familjare të freskët (dy muajt e fundit)
- Vërtetim Page
- Printim të lëvizjeve të llogarisë në banka të tjera ku kanalizohen të ardhurat
- Libreza e energjisë
- Formulari i Pëlqimit Paraprak

Dokumentet për individët e vetëpunësuar /aksioner të subjekteve private

- Kartë identiteti / Pasaportë
- Printim të lëvizjeve të llogarisë në banka të tjera ku kanalizohet aktiviteti
- Certifikatë familjare të freskët (dy muajt e fundit)
- Libreza e energjisë
- Dokumentet Ligjore për aktivitetin (Licenca, NIPT-i, Ekstrakti i QKR)
- Foto të aktivitetit
- Formulari i Pëlqimit Paraprak

#### Shërbime suplementare

Shërbimi plotësues që ofrohet së bashku me Kredinë për Makinë është llogaria e dedikuar e kredisë e cila do të përdoret ekskluzivisht për transaksione të lidhura me kredinë.

#### Rreziqet e "Kredi për makinë"

Monedha e kredisë do të jetë e njëjtë me monedhën e të ardhurave të klientit. Nuk ekziston rreziku i luhatjes së normës së interesit.

Për të dyja llojet e kredisë në Euro/ Lek, ekziston rreziku që lidhet me rregullimin e indeksit të tregut, çdo vit deri në maturimin e kredisë.

#### Struktura e çmimit:

Kredi të akorduara në LEK / EUR: norma e ndryshueshme shprehet në përqindje vjetore dhe përbëhet nga indeksi i tregut plus spreadin e bankës për të gjithë kohëzgjatjen e kredisë.

## Kushtet kryesore ekonomike

Lista e të gjitha kostove dhe shpenzimeve të produktit

#### Norma e Interesit (NI)

Norma vjetore e interesit që Huamarrësi është i detyruar ti paguaj Bankës aplikohet çdo vit; numri i ditëve /360 (treqind e gjashtëdhjetë) dhe llogaritet për shumën e kredisë (Principalin).

Interesi vjetor përbëhet nga elementët e mëposhtëm:

- a) një kuotë e caktuar fikse dhe e pandryshueshme si dhe
- b) norma bazë e interesit, e cila është një kuotë e ndryshueshme, e barabartë me normën vjetore të indeksit të EURIBOR-it/ TRIBOR-it.

#### "Norma Minimale e Interesit" (NMI)

NMI do të thotë vlera më e ulët vjetore, nën të cilën 'Norma Vjetore e Interesit' nuk do të llogaritet në asnjë rast, megjithëse si rezultat i ndryshimeve të 'Normës Bazë të Interesit', 'Norma vjetore e interesit' do të rezultojë në një vlerë më të ulët (për shkak të aplikimit të formulës: Norma Bazë e Interesit + Marzhin).

Norma vjetore e interesit do të jetë e barabartë me normë më të lartë vjetore midis Normës së Interesit (NI) dhe Normës Minimale të Interesit (NMI).

Kredi për makinë– Plani Bazë Standard për Klientin	NI	NMI
Klientë në EUR (per 5 vitet para)	EURIBOR1Y + 5 %	8 %
Klientë në LEK (per 5 vitet para)	TRIBOR1Y + 4.5 %	11 %

#### Shuma që mund të financohet dhe afati

##### Karakteristikat

Shuma maksimale	Makinë e re – deri në Lek 6,000,000 dhe EUR 40,000 / Makina të përdorura – deri në LEK 2,800,000 dhe EUR 20,000
Afati	Makinë e re - deri në 5 vjet / Makinë e përdorur - deri në 3 vjet

#### \*Shëmbull ilustrativ për llogaritjen e kështit të kredisë

Afati	Norma vjetore nominale e interesit	Shuma e kështit mujor për një principal me vlerë LEK 2,000,000.00
për 5 vjet	11 %	LEK 41,400.78
*Nëse klienti do të aplikojë për shumën e kredisë prej LEK 2,000,000.00, për një afat prej 5 vite dhe normë interesi 11% (per 5 vitet para), do të paguajë kështin e kredisë prej LEK 41,400.78 (per 5 vitet para),		
Shuma totale	2,617,606.28 LEK	

Vlera e interesit	617,606.28 LEK
Parametri i indeksimit	TRIBOR1Y / EURIBOR1Y /
Spredi	LEK 4.5 % / EUR 5 % /
Periudha e faljes për normën e interesit	N/A
Penaliteti për pagesën e vonuar të këstit	10%

#### **Kostot dhe shpenzimet për lidhjen e kontratës dhe menaxhimin e marrëdhënies kontraktore**

##### **Kostot dhe shpenzimet për lidhjen e kontratës**

Aktivitetet paraprake	N/A
Vlerësimi teknik	N/A
Pagesa të tjera:	Noterizimi i kontratave paguhet nga Kredimarrësi Sigurimi i jetës* (nëse aplikohet) * Klienti ka të drejtë të zgjedh kompanitë e sigurimit. Shpenzimet në Zyrën e Regjistrimit të Pengut/Barrës Siguruese Sigurimin e plotë Kasko
Komisioni i parapagimit / Përfundimi i një aplikimi për kredi	0.5% e shumës së parapaguar nëse periudha e mbetur deri në maturim është më e vogël se 1 vit; 1% e shumës së parapaguar nëse periudha e mbetur është më shumë se 1 vit.

##### **Kostot dhe shpenzimet për menaxhimin e marrëdhënies kontraktore**

Komisioni i mirëmbajtjes së llogarisë së dedikuar të kredisë	Falas
Komisioni i administrimit	1.5% LEK 1.5% EUR
Kostot e komunikimit:	
Kosto e komunikimeve ligjore shkresore	N/A
Kosto e komunikimeve ligjore online	N/A
Njoftim me shkrim për përfundimin e afatit dhe/ose marrjen e pagesës	N/A
Njoftim elektronik (SMS) për përfundimin e afatit dhe/ose marrjen e pagesës	50 LEK (Opsionale, sipas kërkesës së klientit)
Amendimi i kontratës së huas	150 EUR
Lëshimi i konfirmimit bankar	1000 LEK (Opsionale, sipas kërkesës së klientit)

##### **Plani i amortizimit**

Lloji i amortizimit	Francez
Lloji i këstit	I qëndrueshëm
Periodiciteti i pagesës së interesit	Çdo muaj

## **Ripagimi para afatit, ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore dhe ankesat**

### **Ripagimi para afatit**

Klienti mund të ripaguaj kredinë në çdo kohë duke njoftuar Bankën të paktën 15 ditë përpara datës së likuidimit.

### **Ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore**

Çdo ndryshim i kushteve të përcaktuara shprehimisht në Kontratën e Huasë do të jetë efektiv pas miratimit me shkrim të palëve. Asnjë ndryshim i kushteve të përcaktuara shprehimisht në kontratën e huasë nuk do të jetë efektiv nëse palët nuk bien dakord me shkrim.

### **Ankesat**

Ankesat mund të paraqiten në bankë duke përdorur një nga format e mëposhtme:

- Me shkresë dërguar në Bankë me postë;
- Në degë tek "Kutia e ankesave & sugjerimeve" (Ju dëgjojmë 100%);

- Ankesat me shkrim nëpërmjet llogarisë së email-it në adresën zyrtare të website-it të Bankës si më poshtë:  
complain@intesasanpaolobank.al
- Nëpërmjet qendrës së thirrjeve telefonie Call Center në numrin: 08006000

Afati kohor për përgjigjen nga ana e Bankës është maksimalisht 30 ditë nga data e marrjes së ankesës.

## Fjalorthi i Termave Kryesore

---

**TRIBOR** - (Tirana Interbank Offered Rate- është norma që llogaritet nga Banka e Shqipërisë. Mesatarja llogaritet në bazë të numrit të bankave pjesëmarrëse. Informacioni për llogaritjen e këtij indeksi ndodhen në website: [www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org))

**EURIBOR**- (Euro Interbank Offered Rate, norma e publikuar në sistemin Thomson Reuters në faqen EURIBOR në orën 13:00 CET. Informacioni për llogaritjen e këtij indeksi ndodhen në website: <http://euribor-ebf.eu>)

**Bono Thesari (T-BILL)** - do të thotë Interesi i Rezultuar nga Ankandi i Fundit i Bonove të Thesarit, të emëtuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Informacionet në lidhje me përllogaritjen mund të gjenden në faqen: [www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)